



UDHËZUES MBI PROCEDURAT E RIORGANIZIMIT TË PËRSHPEJTUAR PËR BIZNESET/NDËRMJETËSIT



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Përmbajtja

Pjesa 1 Hyrja dhe qëllimi i Udhëzuesit	7
Pjesa 2 Çfarë është një riorganizim i përshpejtuar në Shqipëri?.....	9
Pjesa 3 Dallimi midis riorganizimit jashtëgjyqësor dhe atij gjyqësor	11
3.1. Përbërja e borxhit dhe marrëdhëniet me debitorin	13
3.2. Kufizimet kohore.....	14
3.3. Privatësia e procedurës	14
Pjesa 4 Fillimi i negociatave jashtëgjyqësore dhe roli i ndërmjetësit	15
4.1. Negocimi.....	15
4.2. Koordinimi i kreditorëve.....	16
4.3. Roli i ndërmjetësit.....	17
Pjesa 5 Marrëveshja për riorganizimin jashtëgjyqësor dhe efektet e saj.....	18
5.1. Përmbajtja e Marrëveshjes.....	18
5.2. Fuqia e Marrëveshjes.....	18
Pjesa 6 Finalizimi i procedurës së riorganizimit të përshpejtuar jashtëgjyqësor.....	20
6.1. Depozitimi i Marrëveshjes në gjykatën e falimentit dhe procedura e riorganizimit të përshpejtuar.....	20

© Korporata Ndërkombëtare Financiare 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue, N.W.

Washington, D.C. 20433 Internet: www.ifc.org

Materiali mbrohet nga e drejta e autorit. Kopjimi dhe/ose transmetimi i pjesëve ose i gjithë këtij materiali pa leje mund të përbëjë shkelje të ligjit në fuqi. IFC nuk garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë material, ose për përfundimet ose gjykimet e përshkruara këtu, dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë lëshim ose gabim (përfshirë, pa kufizim, gabime tipografike dhe teknike) në çfarëdo përmbajtjeje ose për mbështetje në të.

Rreth IFC-së

IFC, një anëtare e Grupit të Bankës Botërore, është institucioni më i madh global i zhvillimit i përqendruar në sektorin privat në tregjet në zhvillim. Ne punojmë në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Në vitin fiskal 2021, ne kemi investuar një shumë rekord prej 31.5 miliardë dollarë në shoqëri private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim, duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët ndërsa ekonomitë përballen me ndikimet e pandemisë COVID-19. Për më shumë informacion, vizitoni www.ifc.org.

RRETH AUTORËVE

KALO & ASSOCIATES (themeluar më 1994) është një zyrë ligjore e cila ofron shërbime ligjore në të gjitha aspektet e ligjit tregtar në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfaqësuar shoqëri dhe agjenci të shquara, të huaja dhe ndërkombëtare, përfshirë disa Fortune 500, që bëjnë biznes në një spektër të gjerë të industrive në të gjithë globin, përfshirë rajonin e Ballkanit. Zyra punëson avokatë të kualifikuar dhe të përkushtuar me përvojë të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve ligjore të sofistikuara dhe komplekse dhe transaksione sipas standardeve ndërkombëtare, në mjedisin lokal. Zyra administron me sukses dhe në kohën e duhur çështje tregtare për shkak të departamenteve të strukturuar: 1) Shoqëritë tregtare (M&A dhe JV), 2) Shërbime bankare dhe financiare, 3) Projektet (koncesione dhe PPP) në fushat e energjisë & burimeve natyrore, 4) Pronësia intelektuale (përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, etiketimin, shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale), 5) Punësimi & migracioni, dhe 6) Përfaqësimi në gjykatë, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. KALO & ASSOCIATES gëzon njohjen rajonale duke qenë një anëtar themelues i SEE LEGAL (South East European Legal Group), grupi drejtues rajonal i 10 zyrave ligjore, të cilat ofrojnë shërbime ligjore cilësore, duke përfshirë transaksione tregtare ndërkufitare në 12 juridiksione të SEE LEGAL që prej 2003.

ANDRÉS F. MARTÍNEZ është Specialist i Lartë në Sektorin Financiar në fushën e Falimentit dhe Zgjidhjes së Borxhit, pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin. Andrés është diplomuar në fushën e të drejtës në vitin 2000 dhe ka praktikuar ligjin e falimentit në një kompani të madhe ligjore në Argjentinë, që kur u pranua në dhomën e avokatëve (2001) deri në 2008, kur u bashkua me Grupin e Bankës Botërore. Ai ka drejtuar treguesin e “paaftësisë paguese” të “Doing Business” (të Bërit Biznes) të Grupit të Bankës Botërore deri në 2011 dhe që atëherë ka ofruar konsulencë në disa vende në lidhje me reformën në fushën e falimentit dhe zgjidhjes së borxhit, në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine, Azinë Lindore dhe Lindjen e Mesme. Në pozicionin e tij aktual, ai drejton dialogun me disa qeveri në lidhje me çështje teknike në fushën e zgjidhjes së borxhit dhe paaftësisë paguese.

SERGIO A. MURO punon si Konsulent në fushën e Falimentit dhe Zgjidhjes së Borxhit (me fokus tek falimenti dhe zbatimi i kontratës), pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin. Që në 2016, ai ka ofruar konsulencë vendeve të ndryshme mbi reformën për zgjidhjen e borxhit, duke përfshirë sistemet e falimentit dhe rekuperimin e borxhit në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, Azinë Lindore, dhe Lindjen e Mesme. Përveç kësaj, ai drejton Projektin e Gjykatës së Lartë Argjentinase në Universidad Torcuato Di Tella, ku ai studion mënyrën si merren vendimet e Gjykatës së Lartë.

PROJEKTI DHE PËRBËRJA E GRUPIT

Menaxheri i Projektit | Igor Matijevic, është një Specialist i Lartë i Sektorit Financiar në Departamentin e Këshillimit për Krijimin e Tregjeve pranë Grupit të Bankës Botërore (IFC/ WBG), me eksperiencë prej 15 vitesh në këtë organizatë ndërkombëtare në disa shtete të Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) me fokus kryesisht në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, ai është Menaxher Rajonal i Projektit Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja e Biznesit.

në Ballkanin Perëndimor, në kuadër të së cilit organizon dhe lehtëson zbatimin e tij në pesë shtete (Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Maqedonia e Veriut dhe Serbi) nëpërmjet komunikimit dhe koordinimit me klientët qeveritar, agjencitë dhe institucionet, si dhe rrjetit të gjërë të palëve të interesit ndërkombëtar dhe lokal. Z. Matijevic zotëron dije të thella dhe eksperiencë në legjislacionin dhe zbatimin e zgjidhjes së borxhit, shoqëruar me një mirëkuptim të fortë në mundësimin e biznesit dhe në reformat e sektorit financiar.

Koordinatorja e Projektit Irena Gribizi, i është bashkuar IFC-së që në vitin 2001 dhe ka punuar si Drejtuese Operacionale për menaxhimin e disa projekteve në Shqipëri me fokus zhvillimin e sektorit privat. Nga viti 2012 znj. Gribizi, Profesioneiste e Certifikuar në Menaxhim Projektit (PMP) është angazhuar si konsulente për IFC-në/Grupin e Bankës Botërore dhe në cilësinë e koordinatorës për Shqipëri ka drejtuar projektet për përmirësimin e klimës ku operon biznesi, ku mund të përmendim: Thjeshtësimi i Taksave dhe Transferimi i Çmimit, Logjistika Tregtare në Ballkanin Perëndimor, Klima e Investimeve dhe Konkureshmëria në Agrobiznes, Mbështetja për Lehtësimin e Tregtisë dhe Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja nga Biznesi. Si pjesë e projektit të fundit, ajo ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në negociatat me klientët qeveritarë, në hartimet e propozimeve për projektin, në koordinimet e aktiviteteve në vend dhe në menaxhimin e gjithë ekipit lokal dhe të huaj për projektin. Znj. Gribizi ka mbështetur projektin veçanërisht në disa seminare të nivelit të lartë me zyrtarë të qeverisë, sikurse ka drejtuar me sukses procesin e hartimit të ligjit të ri për falimentin në Shqipëri.

Nën mbikqyrjen e: Damien Shiels, Menaxher i Praktikës (IFC AS), në Evropën Lindore & Azinë Qëndrore, Praktika Globale për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin dhe Mahesh Uttamchandani, Menaxher i Praktikës, EFNFI, Praktika Globale për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin.

1 Hyrja dhe qëllimi i Udhëzuesit

Në kuadër të Fazës II të Projektit të Zgjidhje së Borxhit, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG), me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), kërkoi përgatitjen e një Udhëzuesi mbi riorganizimin e përsheptuar, në vijim referuar thjeshtë si “Udhëzuesi”, i cili do të shpjegojë rregullat dhe procedurat e parashikuara nga ligji nr. 110/2016 “Për falimentimin” (“LF”) dhe aktet nënligjore^[1] përkatëse për këtë lloj riorganizimi të debitorëve në gjendje paaftësie paguese.

Udhëzuesi do të ofrojë mundësinë për t’u njohur me procedurat që nga fillimi i tyre deri në përfundimin e riorganizimit të përsheptuar midis debitorit/ve dhe kreditorit/ve të tij. Në përputhje me dokumentet e tjera të ngjashme të përgatitura për këtë projekt, ky Udhëzues i jep lexuesit informacion të detajuar mbi risinë e sistemit shqiptar të falimentimit.

Në këndvështrimin e një përjasje paraprake, mund të thuhet se riorganizimi i përsheptuar është një mundësi tërheqëse për debitorët që janë në një situatë të pashmangshme falimentimi, e cila mund t’i godasë ata brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Qëllimi i kësaj procedure është të trajtojë paraprakisht në thelb vështirësinë financiare duke arritur një konsensus mbi një plan riorganizimi kryesisht jashtëgjyqësor dhe ta bëjë të vlefshme këtë marrëveshje përmes një procedure të përsheptuar të parashikuar në LF. Kjo mundësi ofrohet ndërsa debitori është ende në gjendje të përmbushë detyrimet e tij. LF-ja, duke ndjekur linjën dhe procedurat e legjislacioneve të disponueshëm në vendet e ngjashme, nuk ka parashikuar një riorganizim të mirëfilltë jashtëgjyqësor, por përkundrazi ka prezantuar një procedurë hibride (d.m.th. ristrukturim ose riorganizim të përsheptuar), në bazë të së cilës debitori dhe një pjesë e caktuar e kreditorëve mund të lidhin një marrëveshje riorganizimi (“Marrëveshja”), jashtëgjyqësore, e cila duhet të miratohet nga Gjykata e Falimentimit me procedurë të përsheptuar.

Debitorët në vështirësi financiare mund të përfitojnë nga procedura e re e paraqitur nga LF-ja në një sërë mënyrash të cilat do të përshkruhen nga ky Udhëzues në seksionet vijuese. Një proces riorganizimi efektiv i përsheptuar do t’u mundësonte debitorëve të gjejnë sa më shpejt një hapësirë manovrimi, ndërkohë që kreditorët e tyre do të kenë gjithashtu në dispozicion një mjet të përsheptuar për të përmbushur të drejtat e tyre financiare. Kjo procedurë rrit gjithnjë e më shumë besimin midis palëve, duke kufizuar gjithashtu veprimtarinë e gjykatave, të cilat shpesh herë pengojnë arritjen ose zbatimin e marrëveshjeve të riorganizimit.

Në praktikën ndërkombëtare ekzistojnë katër mënyra kryesore të zhvillimit të procedurave të falimentimit:

- i. ristrukturimi jashtëgjyqësor që është një marrëdhënie e pastër kontraktuale e debitorit me kreditorët e tij;
- ii. procedurë hibride e cila bashkon ristrukturimin jashtëgjyqësor me elementet e

[1] VKM për miratimin e Rregullores për riorganizimin e përsheptuar jashtëgjyqësor (r.d. 03-02-2021, nr. 65), Shqipëri. E disponueshme në: <https://qbz.gov.al/share/kPvLLNFsQXKNkgP8JLVSRa>.

riorganizimit formal;

- iii. riorganizim formal gjyqësor nëpërmjet rehabilitimit financiar;
- iv. falimentimi formal gjyqësor nëpërmjet likuidimit të debitorit.

Procedurat gjyqësore të falimentimit mund të veprojnë si një alternativë, si një shtesë ose si pjesë e një strukture të riorganizimit jashtëgjyqësor dhe procedurave hibride.

Në Shqipëri, LF-ja e përkufizon riorganizimin e përshpejtuar si riorganizimin e një debitori në vështirësi operative nëpërmjet ristrukturimit të borxhit, bazuar në një marrëveshje midis kreditorëve dhe debitorit të hartuar jashtë gjykatës së falimentimit dhe të miratuar nga gjykata me procedurë të përshpejtuar.

Siç mund të vërehet, LF-ja parashikon një procedurë hibride në riorganizimin e përshpejtuar,^[2] me elementë të riorganizimit dhe procedurave jashtëgjyqësore që përfshijnë dhe kërkojnë ndërveprim me gjykatën. Këto procedura hibride kërkojnë përfshirjen e gjykatave si pjesë përbërëse e tyre, por pjesëmarrja e tyre është më pak intensive sesa në procedurat formale të riorganizimit. Si rezultat, procedurat e përshpejtuara të riorganizimit përfshijnë afate procedurale shumë më të shkurtra. Procedurat hibride të tipit shqiptar, siç do të vihet re më vonë në këtë Udhëzues, janë procedura që i lejojnë debitorit të negociojë në mirëbesim dhe në mënyrë konfidenciale me kreditorët e tij, ndërkohë që gjykata vendos pezullimin e veprimeve të kreditorëve.

Qëllimi i këtij dokumenti është t'u sigurojë debitorëve, kreditorëve, administratorëve, ndërmjetësve, avokatëve dhe institucioneve përkatëse shtetërore informacion në lidhje me parimet dhe udhëzimet për riorganizimin e përshpejtuar. Udhëzuesi është i strukturuar në 6 pjesë: (i) hyrja; (ii) çfarë është një riorganizim i përshpejtuar në Shqipëri; (iii) ndryshimi midis riorganizimit jashtëgjyqësor dhe riorganizimit gjyqësor; (iv) negociatat e palëve dhe roli i ndërmjetësit; (v) marrëveshja e riorganizimit jashtëgjyqësor dhe efektet e saj; (vi) finalizimi i procedurës së riorganizimit të përshpejtuar.

[2] Ligji për Falimentimin (r.d. 27-10-2016, n. 110/2016), Shqipëri, neni 122 dhe vijues. Të disponueshëm në: <https://qbz.gov.al/share/9huTDgHRSIGC31VDM2KSSQ>.

2 Çfarë është një riorganizim i përshpejtuar në Shqipëri?

Në hyrje theksuam se sistemi shqiptar i falimentimit njih një proces hibrid duke i dhënë mundësinë kreditorëve dhe debitorit të përshpejtojnë një marrëveshje për riorganizimin e debitorit. Ajo që LF-ja duket se synon është një riorganizim i arritur me marrëveshje midis palëve e cila lidhet me një procedurë të lehtësuar për sa i përket formaliteteve që karakterizojnë procedurat formale gjyqësore. Përderisa dispozitat ligjore duket se janë të orientuara drejt një riorganizimi të mirëfilltë jashtëgjyqësor në fazën paraprake, procedura është pjesë e një modeli hibrid ku përfshihen komponentë gjyqësorë formal. Faza e fundit ofron disa përfitime, duke përfshirë një reduktim të mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga një riorganizim i mirëfilltë i arritur me marrëveshje.^[3]

Për ta përmbledhur: Negocimi kryesor zhvillohet jashtë gjykatës, ndërmjet debitorit dhe një numri të caktuar kreditorësh, të cilët përfaqësojnë shumicën e përcaktuar me ligj (të paktën 50 deri në 65 të vlerës së kërkesave, në varësi të përmbajtjes së planit në çdo klasë). Pasi palët arrijnë një plan riorganizimi, i cili mund të jetë thjeshtë financiar (d.m.th. ristrukturim i borxhit) ose edhe operacional (d.m.th. i lidhur me veprimtarinë e biznesit), ky plan i paraqitet gjykatës për verifikimin e kërkesave ligjore dhe miratimi i tij ka efekte të ngjashme me miratimin e një plani riorganizimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme: E meta më e madhe e një mekanizmi të mirëfilltë «jashtëgjyqësor» («i mirëfilltë» që do të thotë pa përfshirjen e gjykatës) është se efektet e tij janë vetëm për palët që nënshkruajnë atë marrëveshje. Për këtë arsye, nëse ka pengesa, ato janë jashtë planit dhe, me shumë mundësi, mund të vazhdojnë veprimet e tyre ligjore kundër debitorit. Kjo ndryshon për procedurat hibride, siç është ajo e parashikuar në LF. Nëse arrihet shumica e caktuar e kreditorëve^[4], vlefshmëria gjyqësore e planit të riorganizimit e kthen atë në të detyrueshëm për kreditorët kundërshtues dhe jo pjesëmarrës, që janë brenda objektit të planit. Për këtë arsye, riorganizimet hibride (ndryshe nga riorganizimet e mirëfillta «jashtëgjyqësore») zgjidhin çështjen e pengesave. Në disa juridiksione, këto riorganizime hibride quhen gjithashtu «procedura të standardizuara riorganizimi» ose riorganizime «të paradakordësuar» dhe ato janë plotësisht në përputhje me Parimin B.4.2 të Raportit të Bankës Botërore për të drejtat e debitorit dhe kreditorëve, i cili parashikon se «B4.2 Kur procedura joformale mbështetet në një riorganizim, procedura formale duhet të jetë në gjendje të përpunojë shpejt marrëveshjen joformale, të negociuar paraprakisht.^[5]

Edhe pse përfshirja e gjykatës kërkon kosto shtesë, nëse është i suksesshëm, një riorganizim i tillë bashkëpunues është shumë më pak i kushtueshëm sesa një procedurë e plotë gjyqësore falimentimi. Përpara se të nisin procedurat gjyqësore të falimentimit, debitori dhe kreditori kanë një mundësi për të rënë dakord reciprokisht për ristrukturimin e borxhit, si rezultat i të cilit të dyja palët përpiqen të arrijnë një marrëveshje për të strukturuar kushtet e shlyerjes së borxhit në një mënyrë që lejon debitorin të vazhdojë aktivitetin. Në të vërtetë, siç ndodh shpesh edhe në praktikë, palët në

[3] Faza në gjykatë kryhet duke vërtetuar dhe miratuar kontratën e ristrukturimit.

[4] Shumica duhet të jenë të njëjta me ato të planit të riorganizimit, sipas Nenit 132 të LF-së

[5] Banka Botërore "Parimet për paaftësinë paguese efektive dhe regjimet kreditore/debitore", 2016. E disponueshme në <https://www.worldbank.org/en/topic/financialsector/brief/the-world-bank-principles-for-effective-insolvency-and-creditor-rights>

rastet e falimentimit përpiqen fillimisht të negociojnë një riorganizim me konsensus jashtëgjyqësor. Negociatat jashtëgjyqësore i lejojnë palët të diskutojnë pa bërë publike vështirësitë financiare të debitorit ndaj palëve të treta (publik, kontraktorët e debitorit, etj.) dhe pa zbatuar asnjë rregull të përcaktuar nga procedurat formale gjyqësore. Sapo kalojnë në fazën gjyqësore, miratimi i gjykatës strehon dhe mbron marrëveshjen kundër sfidave të mundshme të veprimit të anulimit në të ardhmen.^[6]

[6] Në mekanizmat e mirëfillta jashtëgjyqësore, kjo priret të jetë problem në legjisllacionet përkatëse. Veçanërisht në Shqipëri, riorganizimet jashtëgjyqësore parashikojnë mbrojtje në Nenin 79 të LF-së dhe rregullores së tij dhënë me Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 65 /2021 “Për miratimin e Rregullosës për riorganizimin e përsheptuar të marrëveshjeve jashtëgjyqësore” miratuar për të përmbushur kërkesat e nenit 79 të LF-së. Kjo rregullore është hartuar për të përcaktuar rregullat për zbatimin e riorganizimit jashtëgjyqësor në mënyrë të drejtë dhe të përsheptuar, e cila, nga ana tjetër, mbron këto marrëveshje në një mënyrë që në një skenar likuidimi, ato nuk mund të shfuqizohen nga gjykata, duke pasur parasysh disa kërkesa të përcaktuara në të dhe në Nenin 79 të LF-së. Megjithëse rregullorja duket se nuk është përdorur ende në praktikë, pritet që kreditorët, debitorët dhe palët e tjera të interesuara si ndërmjetësit të përfitojnë prej saj. Konkretisht, ndërmjetësit kanë treguar një interes shumë të madh për këtë rregullore, pasi mund ta përdorin atë si një rrymë të re biznesi, në kuptimin që ndërmjetësit do të synojnë të ndërmjetësojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis kreditorëve dhe debitorit deri në lidhjen e marrëveshjes së riorganizimit. Megjithatë, vlen të përmendet se rregullorja nuk imponon përdorimin e ndërmjetësit apo ndërmjetësve për të arritur një marrëveshje. Është në gjykimin e palëve nëse do të përdorin një ndërmjetës në procesin e riorganizimit jashtëgjyqësor.

3 Dallimi midis riorganizimit jashtëgjyqësor dhe atij gjyqësor

Pavarësisht nga forma e procedurës, qoftë nëpërmjet riorganizimit jashtëgjyqësor apo gjyqësor, mund të arrihet një ndryshim, për aq kohë sa është në mënyrë reciproke i dobishëm dhe në kuadër të tij të jenë marrë vendimet e duhura strategjike. Duke marrë parasysh se shoqëria është në një gjendje të vështirë financiare ose në prag të mospërbushjes së detyrimeve të saj (dhe rrezikon humbjen e asetëve për shkak të një marrëveshjeje të pa përmbushur, shlyerjes së munguar të interesit ose të principalit), riorganizimi bëhet parësor për të rifituar normalizimin e gjendjes financiare të shoqërisë në vështirësi. Si në riorganizimin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, qëllimi i përbashkët është që debitori të rifillojë të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme ekonomikisht. Por për një riorganizim jashtëgjyqësor, procesi mund të jetë një mekanizëm më i thjeshtë, më ekonomik dhe më efikas për të modifikuar strukturën e kapitalit të një shoqërie^[7]. Llojet e ndryshme të procedurave të zgjidhjes dhe riorganizimit janë të vendosura në një spektër që varion nga procedurat joformale në ato formale, duke reflektuar -në thelb- shtrirjen e diapazonit në atë masë sa kërkohet përfshirja institucionale (Figura 1).

Figura 1. Vazhdimësia e procedurave të riorganizimit nga formale në joformale



Burimi: "Paketë udhëzuese mbi zgjidhjet në Korporata", Banka Botërore, 2022.

Debitorët këshillohen të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për t'u riorganizuar në proceset jashtëgjyqësore, duke pasur parasysh se në përgjithësi, ky skenar është më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm se procedura standarde gjyqësore të falimentimit.

Megjithatë, ndërsa procedurat e mirëfillta jashtëgjyqësore janë përgjithësisht të disponueshme për një debitor dhe kreditorët e tij për të negociuar mbi baza kontraktuale, LF-ja, siç u shpjegua më parë, parashikon një alternativë hibride. Për të kuptuar më tej karakteristikat e procedurave të ndryshme të disponueshme, ky seksion bën dallimin midis ristrukturimit bazuar në procedurat e standardizuara të riorganizimit dhe proceseve të thjeshta gjyqësore (d.m.th. procedura standarde sipas LF-së).

Duhet të theksohet se një ristrukturim hibrid mund të mos jetë gjithmonë i mundur pasi duhet të merren parasysh disa faktorë:

- debitori duhet të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të operuar gjatë negociatave

[7] Wall Street Prep, 2022, "Riorganizimi Jashtëgjyqësor kundrejt atij Gjyqësor", i aksesuar në janar, 2022. <https://www.wallstreetprep.com/knowledge/out-of-court-vs-in-court-chapter-11-restructuring/>

me kreditorët e tij. Duke marrë parasysh situatën e debitorit (d.m.th. se paaftësia paguese pritet brenda gjashtë muajve të ardhshëm), ky i fundit, përpara se të ulet në negociata me kreditorët, duhet të sigurojë që ka likuiditet të mjaftueshëm për të marrë parasysh masat e vërteta që do të përcaktojnë bazën e marrëveshjes jashtëgjyqësore të riorganizimit. Nëse nuk ka likuiditet minimal për të kryer procedurën e përshpejtuar të riorganizimit dhe sigurimi i kapitalit qarkullues shtesë për periudhën e negociatave nuk është i mundur, atëherë procedura standarde gjyqësore është zakonisht një alternativë më e mirë;

- palët kryesore të interesuara në këtë procedurë, që janë kreditorët, duhet të jenë të gatshëm të negociojnë me debitorin;
- diskutimet duhet të kenë një qasje konstruktive dhe në përgjithësi kërkojnë që kreditorët të kenë besim në planin e biznesit të paraqitur nga debitori dhe aftësinë e drejtuesve për ta zbatuar atë;
- debitori duhet të jetë në gjendje të kapërcejë problemet e tij financiare pa kaluar në procedurat e falimentimit.

Palët duhet të bashkëpunojnë në mirëbesim dhe siç parashikohet në rregulloren “Për miratimin e rregullore për marrëveshjet e riorganizimit të përshpejtuar jashtëgjyqësore” (Rregullorja) miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 65/2021, duhet të jenë të detyruara në mënyrë të ndërsjellë për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë në procesin e negociatave.^[8] Duhet respektuar drejtësia, barazia dhe të ruhet transparenca.

Karakteristikat kryesore të hapave procedurale gjyqësore dhe jashtëgjyqësore mund të shihen në tabelën e mëposhtme:

Aspektet kryesore të Riorganizimit Gjyqësor dhe Riorganizimit të Përshpejtuar
Procedura gjyqësore e riorganizimit:
Gjykata e falimentimit merr vendimin përfundimtar në bazë të akteve.
Gjykata e falimentimit shqyrton në dhomë këshillimi.
Vendimet dhe urdhrat e gjykatës janë menjëherë të zbatueshme.
Ankimet kundër vendimeve të gjykatës së falimentimit nuk pezullojnë zbatimin e tyre, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.
Gjykata e falimentimit shqyrton dhe vendos për kërkesën për nisjen e procedurës së falimentimit jo më vonë se 60 ditë nga paraqitja e kërkesës në sekretarinë e gjykatës.
Gjykata e falimentimit, në varësi të natyrës së çështjes, e shqyrton çështjen verbalisht në seancë ose në dhomën e këshillimit në bazë të akteve me shkrim.
Mosparaqitja e palëve në gjykatë nuk pengon vazhdimin e çështjes.

Gjatë hetimit gjyqësor, gjykata e falimentimit mund të marrë si provë mendimin e ekspertit të palës dhe/ose të ekspertit të caktuar nga vetë gjykata e falimentimit.

Procedura e riorganizimit të përsheptuar (hibride):

Debitori ose kreditorët krijojnë një korrespondencë formale për të filluar procedurën e ristrukturimit ndërmjet tyre.^[9]

Fillimi i procedurës së riorganizimit të përsheptuar pezullon të gjitha ekzekutimet mbi pasuritë e debitorit që janë të nevojshme për vazhdimin e veprimtarisë së tij tregtare.^[10]

Fillimi i procedurës së përsheptuar të riorganizimit nuk pezullon akumulimin e interesave.^[11]

Debitori u jep kreditorëve pjesëmarrës në negociata informacion të plotë për aktivitetin financiar, parashikimin financiar, të dhëna për aktivet dhe çdo informacion tjetër që vlerësohet për shoqërinë siç konsiderohet e nevojshme nga kreditorët.^[12]

Organizimi i Komitetit të Kreditorëve (vetëm nëse marrin pjesë 10 ose më shumë Kreditorë).^[13]

Nënshkrimi i “Marrëveshjes jashtëgjyqësore të riorganizimit”, përpara noterit.^[14]

Palët paraqesin në gjykatë vetëm marrëveshjen e nënshkruar.^[15]

Duke marrë parasysh aspektet pozitive të një procesi jashtëgjyqësor (pavarësisht se në Shqipëri ky proces është i një natyre hibride siç diskutohet në këtë udhëzues) duhet të merren në konsideratë disa aspekte të tjera siç janë:

1. Përbërja e borxhit dhe marrëdhëniet me debitorin.
2. Kufizimet kohore.
3. Privatësia e procedurës.

Aty ku numri i kreditorëve është i madh dhe debitori ka një strukturë të ndërlikuar të shoqërisë, mund të jetë më e vështirë që një procedurë hibride të jetë e suksesshme. Në rastet kur numri i kreditorëve është i madh, shanset për të hasur kundërshtime ndaj një marrëveshjeje riorganizimi mund të jenë më të larta. Kjo lehtësohet nga fakti se shumica që duhet të arrijë debitori për miratimin e suksesshëm të planit të riorganizimit është saktësisht e njëjtë me riorganizimin e përsheptuar (ose hibrid) si në procesin e riorganizimit jashtëgjyqësor (neni 132 i LF-së).

Kur numri i kreditorëve është më i vogël, bëhet më e lehtë për debitorin që të ulet dhe të

[9] Neni 5 i Rregullores

[10] Neni 126 i LF-së dhe 6 i Rregullores

[11] Neni 126 i LF-së

[12] Neni 3 i Rregullores

[13] Neni 7 i Rregullores

[14] Neni 8 i Rregullores

[15] Neni 123 i LF-së

negociojë për një plan të riorganizimit të përsheptuar me ata. Në perspektivën e procesit të negociatave, për të sjellë palët më afër një marrëveshjeje, elemente të tilla si:

- a. shkaku i rënies financiare të shoqërisë dhe nëse është thjesht një gjendje e përkohshme;
- b. shpjegime për arsyet e paaftësisë së anëtarëve kryesorë të stafit që çojnë në probleme financiare; dhe
- c. shfaqja e vullnetit dhe angazhimit të administratës për të kapërcyer gjendjen aktuale të vështirësisë financiare të shoqërisë,

mund të përdoret për të krijuar skenarë bashkëpunimi me kreditorët.

3.2 Kufizimet kohore

Siç nënkupton edhe termi, një nga arsyet për të ndjekur si mundësi riorganizimin e përsheptuar është shmangia e procedurave të gjata gjyqësore të cilat përfshijnë edhe shpenzimet përkatëse. Për më tepër, duke pasur parasysh lirinë që ofron një procedurë e tillë hibride, kryerja e negociatave dhe organizimi ndërmjet palëve në momente më të përshtatshme mund të shmangë shumë telashe dhe të zvogëlojë kostot për një shoqëri e cila është në nevojë urgjente për të përqëndruar të gjithë vëmendjen e saj për të rifituar stabilitetin e saj financiar.

Procedurat gjyqësore të falimentimit, nga ana tjetër, janë formale dhe kërkojnë respektim të rreptë të të gjitha hapave të përcaktuara nga LF-ja. Si të tilla, procedurat formale nuk ofrojnë të njëjtin nivel fleksibiliteti i cili lejon përshtatjen me nevojat e palëve.

Për sa i përket përfshirjes së gjykatës në ristrukturimin e përsheptuar, ajo kërkohet kryesisht për autorizimin e marrëveshjes së riorganizimit të përsheptuar të finalizuar^[16], e cila nuk pengon procesin e negociatave ndërmjet palëve.

3.3 Privatësia e procedurës

Duke qenë se procedura e negociatave është plotësisht në duart e palëve të përfshira, ajo lejon negociatat private me dyer të mbyllura, duke e bërë më të lehtë organizimin e takimeve në mënyrë që të shmangët ndërprerja e aktivitetit të përditshëm të debitorit. Ky parim është parashikuar shprehimisht edhe në Rregulloren^[17]. Për më tepër, ai u mundëson debitorëve të angazhohen në negociata pa ndikuar negativisht në imazhin publik të biznesit.

Nga ana tjetër, procedurat gjyqësore të riorganizimit përfshijnë një nivel publiciteti që mund të shkaktojë kosto jo të drejtpërdrejtë për debitorin edhe përpara se negociatat me kreditorët të finalizohen. Për shembull, klientët e mundshëm mund të largohen pas regjistrimit për nisjen e procedurave formale të riorganizimit të alarmuar nga njoftimi i dhënë për hapjen e procedurave të falimentimit.

[16] Ligji për Falimentimin (r.d. 27-10-2016, n. 110/2016), Shqipëri, neni 79.

[17] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 4.

4 Fillimi i negociatave jashtëgjyqësore dhe roli i ndërmjetësit

Negocimi jashtëgjyqësor është një proces negociimi jo zyrtar ndërmjet debitorit dhe kreditorëve që mund të marrë forma të shumëfishta. Secila prej negociatave jashtëgjyqësore mund të kthehet në plan riorganizimi nëse shumica ribashkohet dhe ndiqet procesi i parashikuar në nenin 121 e në vijim të LF-së. Megjithatë, për t'iu dhënë mbrojtja e parashikuar në nenin 79.4 të LF-së kundër veprimeve të mundshme të anulimit, Rregullorja parashikon një procedurë të standardizuar që fillon me paraqitjen e kërkesës për negociata nga debitori ose nga më shumë se një kreditor. Nuk ka asnjë kërkesë formale për formën ose përmbajtjen e kërkesës pasi ajo mund të paraqitet në çdo formë që vërteton paraqitjen e saj tek pala tjetër^[18]. Kreditorët mund të shprehin miratimin e tyre për fillimin e procedurave standarde të negociatave në çdo formë që vërteton dhënien e një miratimi të tillë për të diskutuar dhe negociuar me debitorin.

I takon palëve të përcaktojnë datën dhe vendin e fillimit të procedurës jashtëgjyqësore të përshpejtuar të falimentimit. Kreditorë të tjerë mund t'i bashkohen kësaj procedure deri në nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet palëve^[19].

Si rregull i përgjithshëm, të gjitha ekzekutimet mbi pasuritë e debitorit të cilat janë të nevojshme për vazhdimin e veprimtarisë tregtare pezullohen vetëm me fillimin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar. Megjithatë, debitori dhe kreditorët mund të bien dakord për një pezullim të tillë nëpërmjet një "Marrëveshje Bllokuese" që vendos një moratorium në ushtrimin e pretendimeve të një kreditori dhe mund të vendosë disa detyrime ndaj debitorit, duke përfshirë një ose më shumë nga sa vijon:

- ndalimin e ndërmarrjes së veprimeve të administrimit të jashtëzakonshëm, me përjashtim të rasteve kur veprimet konsiderohen të nevojshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë;
- ndalimi i transferimit të kuotave ose aksioneve të shoqërisë;
- detyrimi për të informuar kreditorët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë^[20].

Mospërmbushja e këtyre detyrimeve nga debitori i jep të drejtë kreditorit të ndërpresë procedurën e negociimit^[21].

4.1. Negocimi

Gjatë fazës së negociatave, debitori në veçanti ka detyrimin të japë informacion të saktë dhe të plotë me qëllim arritjen e një Marrëveshjeje. Debitori duhet t'u sigurojë të gjithë kreditorëve pjesëmarrës në negociata informacion të plotë në lidhje me:

[18] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përshpejtuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 5.1.

[19] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përshpejtuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 5.2.

[20] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përshpejtuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 6.1.

[21] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përshpejtuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 6.2.

- veprimtarinë financiare të debitorit dhe rrethanat që shkaktuan paftësinë paguese;
- listën e kreditorëve dhe detyrimet përkatëse ndaj secilit prej tyre;
- parashikimet financiare, duke përfshirë parashikimin e humbjeve dhe fitimeve të parashikuara, si dhe raportin e pasqyrave financiare gjatë periudhës së zbatimit të Marrëveshjes;
- të dhëna për shumat, aktivet, si dhe pasuritë e debitorit që mund të përdoren për vazhdimin e veprimtarisë tregtare, si dhe përmbushjen e detyrimeve të kreditorëve, sipas marrëveshjes së riorganizimit;
- çdo informacion tjetër që kreditorët e gjejnë të nevojshëm për vlerësimin e gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të debitorit për zbatimin e Marrëveshjes së propozuar^[22].

Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e çdo të dhëne ose informacioni të dhënë nga debitori ose kreditorët gjatë ose pas negociatave për hartimin e Marrëveshjes, pavarësisht nëse Marrëveshja është finalizuar apo jo, si dhe të mos përdorin ose shpërndajnë informacionet e marra gjatë këtyre bisedimeve pas përfundimit të tyre. Pavarësisht nga këto kufizime të konfidencialitetit, palët nuk janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave ose informacionit të marrë gjatë negociatave në rastet e mëposhtme:

- ofruesi i informacionit jep shprehimisht miratimin e tij;
- informacioni kërkohet nga Autoritetet të cilave u është dhënë nga ligji e drejta për të pasur një informacion të tillë;
- pala pjesëmarrëse në negociata e përdor këtë informacion për të kërkuar përmbushjen e një të drejte ose interesin e saj legjitim ndaj palës tjetër.^[23]

Pala që shkel detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj palës tjetër.

4.2. Koordinimi i kreditorëve^[24]

Kreditorët në procedurën e negociatave jashtëgjyqësore kanë të drejtë të krijojnë një komitet kreditorësh vetëm nëse në negociatim marrin pjesë të paktën 10 (dhjetë) kreditorë. Komiteti i krijuar do të lejojë përfaqësimin e kreditorëve në diskutimet me debitorin.

Komiteti i kreditorëve përbëhet nga të paktën 3 (tre) kreditorë. Mbledhja për zgjedhjen e komitetit të kreditorëve zhvillohet me pjesëmarrjen e të paktën 75 (shtatëdhjetë e pesë) % të kreditorëve pjesëmarrës në negociata. Anëtarët e komitetit të kreditorëve caktohen me shumicë të thjeshtë votash të kreditorëve pjesëmarrës në mbledhje.

Marrëveshja votohet dhe nënshkruhet nga secili prej kreditorëve pavarësisht nga vendimi i komitetit të kreditorëve gjatë procedurave të negociatimit.

[22] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 3.

[23] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 4.

[24] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor" (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 7.

4.3. Roli i ndërmjetësit

Ndërmjetësimi është një veprimtari e pavarur jashtëgjyqësore e rregulluar nga Ligji 10385/2011, "Për ndërmjetësimin", në të cilin palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ose zhvillimin e negociatave ndërmjet tyre nëpërmjet një personi të tretë asnjës (ndërmjetës), për të arritur një zgjidhje të pranueshme. Zakonisht mund të kuptohet se një proces ndërmjetësimi dhe një ndërmjetës mund të përshtaten lehtësisht në një riorganizim jashtëgjyqësor të një debitori, veçanërisht para dhe gjatë procesit të negociatave deri në lidhjen e Marrëveshjes. Megjithatë, duhet theksuar se ndërmjetësit nuk kanë të drejtë të urdhërojnë ose detyrojnë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ose në këtë rast Marrëveshjen.

Debitorët dhe/ose kreditorët mund të kërkojnë që ndërmjetësuesit të jenë të pranishëm gjatë procedurave të negociatave dhe nëpërmjet ndërmjetësit të hartojnë, negociojnë dhe finalizojnë Marrëveshjen.

Sa më sipër, është shumë e rëndësishme të theksohet se palët kanë të drejtën por jo detyrimin të përdorin një ndërmjetës në proces.

As LF-ja dhe as Rregullorja nuk parashikojnë shprehimisht përdorimin e një ndërmjetësi në proces. Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën e procedurës së negociatave jashtëgjyqësore, ndërmjetësimi ndonjëherë mund të jetë një mjet i dobishëm për të lehtësuar në arritjen e një rezultati të suksesshëm të procesit të negociatave.

5 Marrëveshja për riorganizimin jashtëgjyqësor dhe efektet e saj

Marrëveshja duhet të bëhet me akt noterial, përndryshe ajo është e vlefshme vetëm për ata kreditorë që kanë votuar për miratimin e saj dhe janë palë në Marrëveshje.

Në rastet kur procedura standarde e negocimit nuk është respektuar, debitori mund të garantojë përmbushjen e detyrimeve, në çfarëdo mënyre të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, deri në përfundimin e negociatave^[25]. Kjo garanci zakonisht përbëhet nga hipotekat mbi pasuritë e paluajtshme dhe gjithashtu nga barrët dhe pengjet mbi pasuritë e luajtshme dhe marrëveshjet për kolateralin financiar.^[26]

5.1. Përmbajtja e Marrëveshjes^[27]

Marrëveshja do të përfshijë dhe rregullojë ristrukturimin e detyrimeve të debitorit në një nga mënyrat e mëposhtme:

- duke shtyrë maturimin e borxhit apo datën e shlyerjes së detyrimit;
- duke ulur shumën e pagesës objekt detyrimi;
- duke zëvendësuar detyrimet ekzistuese të prapambetura me detyrime të reja me një datë më të vonë maturimi ose me një detyrim më të vogël;
- duke siguruar burime të reja financimi;
- një kombinim i mënyrave të mësipërme.

Marrëveshja mund të përfshijë çdo masë tjetër të përshtatshme për të cilat palët bien dakord, e cila ka si qëllim ristrukturimin e detyrimeve të debitorit. Përmbajtja e Marrëveshjes duhet të jetë e tillë që të sigurojë, për aq sa është e mundur, bazuar në kritere ekonomike objektive, mundësinë e debitorit për të vijuar veprimtarinë për një periudhë afatmesme, jo më pak se 6 (gjashhtë) muaj.

5.2. Fuqia e Marrëveshjes^[28]

Kushtet dhe afatet e Marrëveshjes, nëse nënshkruhen në përputhje me Rregulloren, janë të zbatueshme edhe në rast se debitori kalon në paaftësi paguese dhe fillojnë procedurat e falimentimit.

[25] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 11.

[26] Ne e konsiderojmë këtë dispozitë më të rëndësishme gjatë fazës së përmbushjes së detyrimeve të debitorit ndaj kreditorëve të tij.

[27] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 9.

[28] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 10.

Çdo pagesë, garanci ose veprim juridik i kryer në zbatim të parashikimeve të Marrëveshjes, do të konsiderohet e vlefshme në kuadër të procedurës së falimentimit.

Në rast se në Marrëveshje palët kanë parashikuar sigurimin e burimeve të reja të financimit nga debitori, këto fonde do të përdoren vetëm për ekzekutimin e marrëveshjes. Në rastin e një gjendjeje të mëpasshme të paaftësisë paguese të debitorit, këto fonde do të konsiderohen pjesë e masës së falimentimit, ndaj të cilës mund të parashtrojnë pretendime të gjithë kreditorët, sipas parashikimeve të LF-së^[29].

[29] VKM "Për miratimin e Rregullores për ristrukturimin e përsheptuar jashtëgjyqësor (r.d. 03-02-2021, n. 65), Shqipëri, neni 11.

6 Finalizimi i procedurës së riorganizimit të përshpejtuar jashtëgjyqësor

Duhet sqaruar se edhe në skenarin më optimist kur debitori arrin një marrëveshje me të gjithë kreditorët, ekzekutimi i kësaj marrëveshje *përse* nuk çon në finalizimin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar jashtëgjyqësor. Siç përmendet më sipër, kjo procedurë finalizohet në Gjykatë duke pasur parasysh që është pikërisht gjykata e falimentimit autoriteti që miraton dhe vërteton përmbajtjen e Marrëveshjes nëpërmjet procedurës së përshpejtuar. Në rast se debitori nuk ka arritur marrëveshje me të gjithë kreditorët, do të kërkohej përpjekje shtesë në interesin e përbashkët gjatë procedurave.

Për këtë arsye, ky Seksion, do të përcaktojë rregullat dhe procedurat e ndërmarra nga gjykata e falimentimit për miratimin e Marrëveshjes dhe përfundimin e procedurës nëpërmjet riorganizimit të përshpejtuar.

6.1. Depozitimi i Marrëveshjes në gjykatën e falimentit dhe procedura e riorganizimit të përshpejtuar

Marrëveshja e nënshkruar duhet të depozitohet në gjykatën e falimentit ku debitori është i regjistruar, brenda 6 muajve nga fillimi i parashikuar i falimentimit, sipas procedurës së kërkesës së rregullt të falimentimit, por me elementë të ndryshëm dhe me afate më të shkurtra në kuadër të hapave procedurale. Rregullat dhe procedurat për riorganizimin e përshpejtuar nga momenti i depozitimit të marrëveshjes së nënshkruar nga debitori deri në përfundimin e procesit parashikohen në nenet 123-134 të LF-së.

Me depozitimin e kërkesës debitori duhet të përfshijë:

- a. të gjitha dokumentet e renditura në gërmat «a» deri në «e», pika 1, neni 14 i LF-së, të përshtatura për paaftësinë paguese të pashmangshme (raporti i debitorit që përmban shkaqet e kësaj paaftësie paguese, pasqyrat financiare për tre vitet e fundit, një listë të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, fluksit të parave dhe burimeve të të ardhurave, një listë të debitorëve dhe kreditorëve, dhe një listë e të gjitha proceseve gjyqësore në të cilat debitori është palë)^[30];

[30] Lista e dokumenteve të kërkuara nga Ligji për Falimentimin në këtë rast është si më poshtë:

- a) një raport nga debitori që tregon shkaqet e falimentimit dhe analizën e debitorit për të ardhmen e biznesit;
- b) ekstraktin e historikut të debitorit të siguruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- c) bilancet dhe pasqyrat financiare të debitorit për tre vitet e fundit të veprimtarisë debitore. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohore, për atë që është kjo periudhë;
- d) një listë të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, duke përfshirë:
 - i. vlerat e çdo aktivi në momentin e blerjes;
 - ii. vlerën aktuale të tregut në rast se i janë nënshtruar rivlerësimit;
 - iii. vendndodhjen e asetëve; dhe/ose të dhëna të regjistruara në regjistrat publikë, nëse ndonjë pasuri e tillë i nënshtrohet ndonjë procedimi ligjor; dhe nëse ndonjë aktiv i tillë është lënë peng si garanci, ose i nënshtrohet ndonjë barre, dhe, nëse po, vlerën e huasë së siguruar;
- e) një listë të tepricës aktuale të parasë dhe burimeve të të ardhurave;

- b. propozimin për planin e riorganizimit, përfshirë përmbajtjen e përkthuar në nenin 98 të LF-së^[31];
- c. Marrëveshjen e nënshkruar të paktën nga kreditori/ët që përfaqëson/jnë +30% ose më shumë të vlerës totale të pretendimeve të regjistruara në llogaritë^[32] e debitorit.

Gjykata do të fillojë një procedurë të riorganizimit të përshpejtuar nëse rezulton se debitori do jetë në gjendjen e paafësisë paguese dhe kërkesa e depozituar është në përputhje me kërkesat e sipërpërmendura. Vendimi i gjykatës për fillimin e procedurës të riorganizimit të përshpejtuar përfshin:

- a. identifikimin e debitorit (në rast se debitori është individ: emri, mbiemri, atësia, data e lindjes, numri personal i identifikimit dhe vendbanimi; ose, nëse debitori është person/ subjekt juridik, emri, lloji i aktivitetit, numri i identifikimit të personit të tatueshëm dhe selinë;
- b. caktimin e një administratori mbikqyrës (së bashku me të dhënat e identifikimit të administratorit, duke përfshirë numrin e licencës për të ushtruar funksionin e administrimit) si dhe një adresë për komunikimin me kreditorët;
- c. kërkesën për çdo person që pretendon se është kreditor, për të paraqitur pretendimet e tij brenda 30 ditëve nga data e publikimit të vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare, si dhe në adresën e dhënë nga administratori mbikqyrës;

.....
 [31] Në mënyrë që kreditorët të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës të informuar siç duhet, plani i riorganizimit duhet të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm në masën e mundshme dhe të zbatueshme, duke përfshirë:

- një raport të përgjithshëm, të saktë të veprimtarisë së debitorit dhe rrethanave që çuan në vështirësitë financiare;
- një listë dhe shpjegim të detajuar të masave për zbatimin e planit;
- një listë të detajuar të kreditorëve të ndarë në klasa të kreditorëve;
- të dhëna për likuiditetin ose aktivet që do të përdoren për shlyerjen e plotë ose të pjesshme të çdo klase kredituesish, aktivet e rezervuara për kreditorët pretendimet e të cilëve janë kundërshtuar, procedurat për zgjidhjen e këtyre pretendimeve dhe kohëzgjatjen e këtyre procedurave;
- përshkrimin e procedurave të shitjes së aseteve, nëse ka, së bashku me një listë të aktiveve që do të shiten me ose pa sigurim interesi dhe përdorimin e të ardhurave nga këto shitje;
- datën e fillimit dhe afatet për zbatimin e planit të riorganizimit;
- një deklaratë të qartë se miratimi i planit të riorganizimit do të çojë në një ripërcaktim të të drejtave të të gjithë kreditorëve, në përputhje me planin, duke përfshirë skenarin kur plani nuk përmbushet ose kur zbatimi i tij pezullohet, dhe detajet se si këto të drejta (të drejtat e kreditorëve) do të ripërcaktohen;
- listën e të gjithë anëtarëve të organit drejtues të debitorit dhe shpërblimet e tyre;
- të dhëna për mënyrën dhe afatet, sipas të cilave debitori do të përmbushë kërkesat e kreditorëve, që rrjedhin nga shitja e të gjitha aktiveve ose e të gjithë ose e një pjese të veprimtarisë, ose nga marrja e kredive ose kapitalit nga palët e treta, ose nga reduktimi i borxhit; ose lehtësimi i borxhi ose shtyrja e afatit të tyre, nga konvertimi i borxhit në kapital ose nga strategji të tjera të parashikuara me ligj;
- emrin e administratorit mbikqyrës të propozuar, nëse ka, dhe raportin që administratori mbikqyrës do t'u paraqesë kreditorëve;
- parashikimet financiare, duke përfshirë vlerësimin e humbjeve dhe fitimit të pritshëm, raportin për pasqyrat ekonomike dhe financiare gjatë periudhës së zbatimit të planit të riorganizimit;
- vlerësimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në rast likuidimi, nëse likuidimi do të ishte kryer në momentin e paraqitjes së planit të riorganizimit.

[32] Ligji për Falimentimin (r.d. 27-10-2016, n. 110/2016), Shqipëri. neni 124.

- d. njoftimin për kreditorët që, brenda 7 ditëve nga momenti i depozitimit të listës së kreditorëve në gjykatën e falimentimit, të paraqesin kundërshtimet lidhur me të;
- e. informacionin se është propozuar një plan riorganizimi i përshpejtuar, i cili është në dispozicion të kreditorëve për t'u njohur me të;
- f. dhënien e informacionit për t'u bërë të ditur kreditorëve të drejtën që të shprehin mbështetjen e tyre për planin e propozuar;
- g. caktimin e një mbledhjeje të kreditorëve për një datë që nuk mund të jetë më vonë se 45 ditë nga momenti i publikimit të vendimit.

Kundër vendimit për fillimin e procedurës së përshpejtuar të riorganizimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes. Ankimi nuk pezullon zbatueshmërinë e planit të riorganizimit, përveçse kur gjykata e apelit vendos ndryshe, mbështetur në shkaqe që çojnë rëndë interesat e kreditorëve ose interesat publikë^[33].

Gjatë procedurave të përshpejtuara të riorganizimit, debitori vazhdon të administrojë biznesin e tij edhe pse çdo transaksion jashtë kursit të zakonshëm do të kërkojë miratimin e administratorit. Ndërkohë, procedurat përmbaremore ndaj debitorit do të pezullohen për të lehtësuar negociatat.

Administratori i emëruar do të hartojë dhe depozitojë një raport të ndërmjetëm për shkaqet e vështirësive financiare të debitorit, si dhe një opinion për qëndrueshmërinë e biznesit. Gjithashtu, një raport përfundimtar mbi planin e përshpejtuar të riorganizimit duhet të depozitohet të paktën një javë përpara votimit.

Të gjithë kreditorët duhet t'i paraqesin administratorit mbikqyrës pretendimet e tyre, me sa më shumë detaje dhe prova të jetë e mundur. Është detyrë e administratorit të shqyrtojë dhe verifikojë pretendimet e kreditorëve dhe të përpilojë një listë kreditorësh e cila do të depozitohet në gjykatë brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave. Lista përmban informacione të ndryshme për kreditorët dhe pretendimet e tyre, të tilla si identiteti i tyre, klasa e kreditorëve, etj.

Pas hartimit të listës së kreditorëve, kreditorët do të votojnë propozimin e riorganizimit të përshpejtuar. Kuorumi dhe miratimet rregullohen nga rregullat që zbatohen për procesin e përgjithshëm të riorganizimit. Kundërshtimet, nga ana tjetër, lejohen vetëm në rast se nuk arrihet shumica e kërkuar^[34].

6.1.1 Mbledhja e kreditorëve për votimin e planit të riorganizimit të përshpejtuar^[35]

Mbledhja e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar kryesohet nga gjykata e falimentimit dhe administratori mbikëqyrës vepron si sekretar. Në këtë rast nuk lejohet delegimi.

Lista e kreditorëve shërben si bazë për listën e pjesëmarrësve në mbledhjen e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar. Në kuadër të votimit të këtij plani, administratori mbikëqyrës reflekton në listë ato pretendime që janë kundërshtuar dhe të cilat nuk janë verifikuar siç duhet. Megjithatë, pretendimet e kundërshtuara trajtohen si të kushtëzuara dhe nuk numërohen për formimin e kuorumit dhe as për qëllime votimi.

[33] Ligji për Falimentimin (dt. 27-10-2016, nr. 110/2016), Shqipëri, neni 124.3.

[34] Marrë nga Komentari i Procedurave të Ligjit për Falimentimin, i përgatitur në fazën e dytë të Projektit i cili bashkon nenet 125 – 133 të të njëjtit.

[35] Ligji për Falimentimin (dt. 27-10-2016, nr. 110/2016), Shqipëri, neni. 131.

Për llogaritjen e kuorumit, krahas kreditorëve të cilët janë të pranishëm në mbledhje, administratori mbikqyrës përfshin pretendimet që kanë mbështetur planin e riorganizimit të përshpejtuar gjatë kërkesës së debitorit dhe të gjitha pretendimet e tjera që kanë mbështetur më pas këtë plan. Kjo do të thotë që këta kreditorë (d.m.th. që kanë mbështetur planin e riorganizimit të përshpejtuar) nuk kanë nevojë të jenë të pranishëm fizikisht në mbledhje, për sa kohë që ata e kanë mbështetur zyrtarisht planin.

Formimi i klasave dhe llogaritja e shumicës për miratimin e planit të riorganizimit të përshpejtuar do të jenë të njëjta si ato të parashikuara për planin e riorganizimit.^[36]

Që plani të konsiderohet i miratuar kërkohet, në çdo klasë, shumica e thjeshtë e vlerës së pretendimeve të kreditorëve aktualë. Megjithatë, kërkohet një shumicë e cilësuar (65%) e klasës së kreditorëve të prekur, kur plani parashikon një reduktim me 50% ose më shumë të pretendimit të tyre ose një riprogramim për më shumë se 5 vjet^[37]. Kreditorët konsiderohen se kanë votuar pro planit, përveç rasteve kur marrin pjesë në mbledhjen e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar dhe votojnë ndryshe.

6.1.2. Efektet e miratimit të planit të përshpejtuar të riorganizimit

Pas miratimit të tij, zbatohet plani i riorganizimit të përshpejtuar, çka sjell gjatë zbatimit të planit vazhdimin e administrimit të biznesit nga ana e debitorit. Parashikimet e vetë planit, përveç debitorit, janë të detyrueshme edhe për kreditorët. Duhet sqaruar se zbatimi i planit vazhdon të mbikqyret nga administratori mbikqyrës, i cili duhet të paraqesë në gjykatë një raport vjetor mbi këtë çështje.

6.1.3. Efektet e refuzimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar^[38]

Nëse plani i riorganizimit të përshpejtuar nuk miratohet, gjykata e falimentimit shpall fillimin e procedurës së zakonshme të falimentimit, përveç rastit kur debitori provon se nuk është në gjendje falimentimi dhe nuk ekziston më gjendja e pashmangshme e falimentimit.

Administratori mbikqyrës vazhdon detyrën nëse nuk ka arsye objektive për të kundërtën.

[36] Sipas LF-së, kreditorët klasifikohen në pesë grupe kryesore:

- Kreditorë të siguar, të cilët kanë të drejta të vlefshme mbi pasuritë e debitorit të siguruara me barrë, hipotekë ose garanci të tjera;
- Kreditorë të preferuar, që kanë një kategori të veçantë pretendimesh, duke përfshirë pretendimet për ndërprerjen e punësimit, pretendimet për dëmtime personale të punonjësve ose dëmshpërblimet për jetën ose shëndetin;
 - Kreditorët fundorë që kanë pretendime për gjokat e vonuara të maturuara përpara fillimit të procedurës së falimentimit, gjoka, shlyerje të huave të kontraktuara me palët e lidhura me debitorin, ose ato që palët kanë rënë dakord t'i klasifikojnë si fundorë;
 - Kreditorët e pasiguar, d.m.th. kreditorët që nuk klasifikohen si të siguar, të preferuar apo fundorë bëjnë pjesë në këtë kategori.
 - Kreditorët me të drejtë përjashtuese, d.m.th. "është pronari i një pasurie në posedim të debitorit, i cili ka të drejtë ligjore ta ndajë këtë pasuri nga masa e falimentimit".
 - Kreditorët e procedurës së falimentimit, pretendimet e të cilëve kanë lindur pas fillimit të procedurës së falimentimit.

[37] Shiko nenin 108 të Ligjit për Falimentimin

[38] Ligji për Falimentimin (dt. 27-10-2016, nr. 110/2016), Shqipëri, neni 134.

Projekti zbatohet nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG) dhe me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:

Z. Igor Matijevic

Menaxher Rajonal për Programin

e-Mail: imatijevic@ifc.org

Znj. Irena Gribizi

Koordinatorë e Projektit për Shqipërinë

e-Mail: igribizi1@ifc.org



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Departement of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO